

Platforma CiviKos me mbështetje të DEMOS kanë formuar **grupin e Auditimit Social në Rahovec**.

Projekti	<b>Ndërtimi i infrastrukturës për persona me nevoja të veçanta</b> (Rahovec, Xërxe, Fortesë, Krushë e Madhe, Celinë, Hoqë e Vogël, Opterushë, Malësi e Vogël, Ratkoc, Dejn dhe Qifllak)
Çmimi total i punëve në kontratë	<b>EUR 71,569.00</b>
Statusi i kontratës	<b>I përfunduar</b>



Grupi i Auditimit Social në Rahovec ka 22 anëtarë.

## GJETJET KRYESORE



Komuna e Rahovecit nuk ka organizuar konsultim të veçantë me qytetarët.



Ka mungesë të vendosjes së pjerrinave në hapësira publike me frekuentim të shpeshtë.



Disa nga pjerrinat e vendosura janë më të ngushta se standardi i lejuar për të kaluar një person me karrocë.



Ka mungesë të shenjave vertikale dhe horizontale që njoftojnë për shtigjet për persona me nevoja të veçanta.



Disa nga zhurmuesit e semaforëve nuk punojnë fare, ose kanë zë shumë të dobët për tu dëgjuar nga shfrytëzuesit.



Ka pasur vonesa në zbatim të projektit.

## REKOMANDIMET

Të vendoset ashensor në objektin e Komunës për t'i mundësuar personave me nevoja të veçanta qasje të plotë në objekt.

Të vendosen pjerrinat në Sheshin e Rahovecit pas ndërtimit të Sheshit.

Të sigurohet mirëmbajtja e rrethojave, pjerrinave, shenjave vertikale dhe horizontale.

Të shikohet mundësia e zgjerimit të pjerrinave aty ku janë më të ngushta se standardi dhe të rregullohen zhurmuesit në semaforë.

Të ndërtohen pjerrina në hapësirat publike me frekuentim të shpeshtë, duke filluar nga objekti i Komunës.

